



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.45

Prishtinë, më 4.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Frashër Krasniqi, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Arben Gashi dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Vlora Selimi- arbresh.info; Fitore Ademi-Rtv21; Burbuqe Ibishi-Kosovapress; Edona Kurteshi-Koha Ditore; Emine Shehu-Ekonomia Online; Bahri Hyseni-KPK; Albana Hajdari-Kosova Post; Jehona Krasniqi-KDI; Agnesa Haxhiu-KDI; Jehona Zhitia-RTK; Donika Voca-KTV; Abelard Tahiri-MD; Nehat Idrizi-KGJK; Ardian Bajraktari-MD, Ardita Hajra-AKMU, Shkëlqim Hysenaj-REL, Pajtim Quni-Radio Kosova, Rreze Hoxha-GLPS, Genc Nimoni-Çohu; Altina Besimi dhe Selvije Fetahu, Ambasada Britanike; Edita Kusari-EUSR-EUO.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256;
3. Diskutim lidhur me gjendjen në Gjykatën e Kosovës në veri të Mitrovicës; Të ftuar: ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi dhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Blerim Isufaj;
4. Të ndryshme.

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se Ministri i Drejtësisë, z. Tahiri ka mbledhje të Qeverisë dhe duhet të shkojë në orën 14:00, dhe meqë nuk kishte kuorum, të fillohet me rendin e ditës. Kryetarja propozoi që të fillojë diskutimi me të ftuarit, z. Nehat Idrizi, z. Abelard Tahiri dhe z. Bahri Hyseni, për të vazhduar pastaj me pikat tjera të rendit të ditës, në momentin që do të bëhet kuorumi. Deputetja Haxhiu shprehu shqetësimin në lidhje me letrën nga kryetari i gjykatës në veri të Mitrovicës, që ka adresuar për pezullimin e punës së asaj gjykate, për shkak të taksës 100%. Po ashtu, deputetja Haxhiu njoftoi të pranishmit se kjo edhe është arsyeja pse janë të ftuar KGJK, KPK dhe ministri i Drejtësisë, që të na njoftojnë zyrtarisht në lidhje me situatën e krijuar.

Diskutim lidhur me gjendjen në Gjykatën e Kosovës në veri të Mitrovicës; Të ftuar: ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi dhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Blerim Isufaj;

Abelard Tahiri, tha se sa i përket gjendjes së krijuar, nuk ka mosfunksionim të gjykatave. Në momentin e dorëheqjes së kryetarëve të katër komunave në veri të Kosovës, njoftoi se ka ftuar në takim Komisionin Evropian, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe USAID-in, për faktin se këta aktorë kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm me instalimin dhe implementimin e marrëveshjes së Brukselit në funksionalizimin e gjykatave në veri, shtoi z. Tahiri. Më pas, ai foli edhe për letrën nga z. Kabashiq, ku tha se këtë letër nuk e ka marrë direkt nga ai, por nga rrugë tjera jozyrtare. Ministri Tahiri e cilësoi si të rëndësishme, se nuk ka ballafaqim të mos-punës në gjykatë, përveç kohës së protestave, të cilat organizohen para Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku kjo periudhë dyorëshe krijon vështirësi në mbarëvajtjen e punës atje, përndryshe nuk kemi informata për ngecje të punës nga gjyqtarët dhe prokurorët, theksoi ministri Tahiri. Ai tha se si Qeveri e Kosovës jemi në mbështetje të të dy këshillave, në mënyrë që zhvillimet politike të mos prekin atë pjesë, kur dihet se që 1 (një) vit janë funksionalizuar gjykatat në atë pjesë të Kosovës dhe natyrisht kur dihet se që 10 vite ka munguar një sistem i yni atje, mund të ballafaqohemi edhe me probleme, por nuk janë probleme që do ta pengonin funksionimin e gjykatave, potencoi ministri i Drejtësisë, z. Abelard Tahiri.

Kryetarja parashtroi pyetje për ministrin e Drejtësisë, a e ka vizituar Gjykatën Themelore në Mitrovicë?

Abelard Tahiri, duke iu përgjigjur pyetjes së deputetes Haxhiu, tha se nuk ka qenë në vizitë në gjykatë, por ka pranuar shkresa nga kryetari i gjykatës, i cili ka konfirmuar se nuk ka pezullim të punës, përveç periudhës dyorëshe të protestës, e cila paraqet problem në hyrje-dalje të qytetarëve. Ministri Tahiri tha se është i shqetësuar nga kjo situatë por shpreson se zhvillimet politike të mos kenë ndikim në punën e gjyqësorit atje.

Nehat Idrizi, tha se KGJK me shqetësim i ka përcjellë zhvillimet e fundit, ku tha se ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me zyrtarët përmes telefonit për t'u informuar me situatën atje, pra

gjendja është stabile dhe pa probleme, puna vazhdon edhe nga stafi administrativ, por edhe nga gjykatësit, përveç kohës kur mbahet protesta. Ndërsa, sa i përket shkresës nga z. Kabashiq, ai tha se e ka siguruar nga rrugët jozyrtare. Këshilli, përmes një shkrese, ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës Themelore dhe përgjegjësi i divizionit, që të përmbahen nga deklaratimet publike, pavarësisht pikëpamjeve të tyre, që kanë të bëjnë me çështjet e caktuara politike, në mënyrë që të ruhet dhe të respektohet parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë, si parime themelore të sistemit të drejtësisë.

Bahri Hyseni, tha se për Këshillin Prokurorial ka qenë pak më lehtë, sepse në prokurori e kemi kryeprokurorin shqiptar dhe komunikimi ka qene direkt, pa asnjë problem, për të marrë informata për lëvizjet që kanë ndodhur në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Pra, nga dita e parë nuk ka pasur asnjë problem me prokurorët dhe stafin, i cili punon në Prokurorinë Themelore. Po ashtu, jemi informuar që puna ka vazhduar pa asnjë pengesë, theksoi prokurori Bahri Hyseni.

Kryetarja, në fjalën e saj të serishme, tha se vazhdon të argumentojë se nuk ka pasur integrim në sistemin e drejtësisë dhe për gjithë këtë proces Serbia ishte vendimtare me negociatat e zhvilluara, pra roli dhe kërkesat që Serbia kishte që njerëz me emra të përveçëm të përfshihen në sistemin e drejtësisë . Pra, nuk është e drejtë të thuhet se integrimi në atë pjesë është histori sukcesi, kur tani po del e kundërta, theksoi deputetja Haxhiu. Më tej, përmendi rastin e Nikolla Kabashiq, ku tha se dy herë radhazi bën veprime të tilla, në rastin e parë me dorëheqje, ku Këshilli Gjyqësor nuk e ka pranuar dorëheqjen e tij dhe rasti i dytë ku znj. Haxhiu tha se është shqetësues se si Këshilli Gjyqësor nuk ndërmer masa për veprimet politike që ky njeri bën. Prandaj, Këshilli Gjyqësor nuk e ka kryer punën në përputhje me kompetencat që i takojnë, sepse është dashur që të ndërmerren masa ndaj zyrtarëve të cilët veprojnë sipas urdhrave të Serbisë, theksoi ajo. Duke iu referuar hulumtimeve të shoqërisë civile për një çështje tjetër shqetësuese, deputetja tha se është edhe pagesa e disa gjyqtarëve, të cilët nuk shkojnë në punë dhe marrin pagat, emrat e tyre janë: Zoran Babiq dhe Rushica Simiq. Deputetja Haxhiu vazhdoi duke thënë se mosveprimi i Këshillit Gjyqësor nga letra që është dërguar nga kryetari Nikolla Kabashiq, ka lënë hapësirë për gjyqtarët tjerë që në të ardhmen të veprojnë në përputhje me urdhrat politikë, por nëse do të ishte ndërmarrë masa ndaj atyre që shkelin ligjin, atëherë edhe të tjerët do të ishin të obliguar që ta respektojnë ligjin, në këtë rast pyetja e parashtruar nga znj. Haxhiu për kryesuesin e Këshillit Gjyqësor ishte si vijon: cili do të ishte veprimi i Këshillit Gjyqësor, në rast se një gjyqtar në një komune tjetër do të vepronte njëjtë?

Bilall Sherifi, tha se problemi në veri të Mitrovicës është politik dhe masat ndëshkimore duhet të merren atëherë kur problemi është administrativ, kur rebelimi është individual, kur mosbindja është individuale, kur ato janë të natyrës politike, siç janë raportet mes Kosovës dhe Serbisë, duke pasur parasysh agresionin e ashpër diplomatik, në vazhdimësi, të Serbisë ndaj Kosovës. Prandaj, masa e vetëmbrojtjes është taksa 100%, dhe pres që të ketë edhe masa tjera. Më tej, deputeti Sherifi tha se zgjidhja e këtij problemi nuk duhet të bëhet përmes masave individuale, por të merremi me ata që kanë filluar këtë luftë të ashpër diplomatike dhe t'i përgjigjemi me

çdo masë që do ta konsiderojmë të nevojshme dhe të domosdoshme për të mbrojtur shtetin dhe dinjitetin tonë.

Hajdar Beqa, tha se si Komision për Legjislacion i kemi pritur me shqetësim informatat për ndërprerje të punës në gjykata në veri të Kosovës, pas dorëheqjeve që kanë ndodhur atje, prandaj qëllimi i këtij takimi është edhe të informohemi se si qëndron situata atje. Deputeti Hajdar Beqa, më tej tha se marrëveshja në mes dy shteteve e Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë ka qenë një e arritur që duhet vlerësuar dhe falë kësaj marrëveshjeje tani kemi një sistem të integruar në veri të Mitrovicës. Në vazhdim, parashtrori pyetje për kryesuesin e Këshillit Gjyqësor si vijon: a keni pasur ndonjë informatë zyrtare nga gjykatat dhe prokuroritë që puna do të ndërpritet?

Sami Kurteshi, tha se duke ditur që gjendja nuk është normale, parashtrori pyetje për të ftuarit. Pyetja e parë kishte të bënte se çka përmban letra e dërguar nga Kabashiq, ndërsa pyetja tjetër ishte se nëse protestat do të zgjasin më shumë se dy orë, si do të jetë e mundur qasja në gjykatë, a ka ndonjë plan B që do t'i jepte zgjidhje këtij problemi. A ka Këshilli Gjyqësor kontakt të drejtpërdrejtë me ndonjë gjyqtar atje?

Frashër Krasniqi, tha se situata e krijuar së fundmi, por edhe situata me Interpolin, më shumë se përgjegjësi individuale është një reflektim i faktit që nuk është arritur një zgjidhje e qëndrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë, sa i përket kontestimit të shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë, por edhe funksionalitetin e shtetit të Kosovës. Sa i përket kësaj situatë, deputeti Krasniqi tha se është mirë që të gjitha palët, të gjitha subjektet të ulen bashkë dhe të shihet se çfarë strategjie duhet ndjekur Shteti i Kosovës, në raport me Serbinë, sepse tanimë është e qartë kur jemi në një situatë kur kërkohet të ketë një zgjidhje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, e cila do ta zhblllokonte Kosovën, qoftë në proceset integruese jashtë, qoftë në funksionalitetin e saj të brendshëm shtetëror.

Shkumbin Demaliaj, tha se çështja që ka prekur më shumë Komisioni për Legjislacion është çështja e involvimit politik të gjykatave dhe prokurorive në veri të Mitrovicës. Ai tha se i sugjeron institucionet që të kenë një kujdes të theksuar në lëndët e pashqyrtuara, në mënyrë që të trajtohen dhe të mos ikin nga duart e drejtësisë. Ndërsa, sa i përket dorëheqjeve, ai tha se nuk janë bërë në mënyrë ligjore, por duke ditur që janë çështje politike, besoj se në një të ardhme të afërt do të rregullohen.

Korab Sejdiu, tha se fatkeqësisht kemi një agresion të hapur nga Serbia, ku në këtë rast kemi edhe Presidentin, i cili po ndihmon në atë drejtim, ku pastaj po dalim në disa rrethana të pafavorshme për institucionet tona, veçanërisht për ato që duhet të jenë jopolitike. Deputeti Korab Sejdiu theksoi se institucionet e pavarura duhet të kryejnë punët e tyre në bazë të ligjit. Pra, duhet të fillojmë të veprojmë si shtet dhe shteti mund të forcohet vetëm nëse drejtësia është e verbër, pavarësisht se për kënd bëhet fjalë, theksoi ai.

Kryetarja, tha se ka qenë gabim shumë i madh që institucionet e drejtësisë kanë bërë negociata politike në Bruksel, kur dihet se kompetencë për ta shtrirë sovranitetin e drejtësisë në pjesën veriore i ka Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial. Pra, Serbia nuk ka nevojë të jetë në këtë proces. Deputetja Haxhiu shtoi se kjo situatë nuk është krijuar tani, por në vitin 2011, kur edhe kanë filluar negociatat me Serbinë dhe marrëveshja për drejtësinë, ku është krijuar edhe Gjykata e Apelit, enkas për serbët e që është në shpërputhje me legjislacionin në fuqi, prandaj, sipas saj, nuk ka sistem unitar.

Hajdar Beqa, tha se e kupton shqetësimin e znj. Haxhiu, por për këtë më mirë është të flasë në Kuvend ose në konferencë për media, meqë tema që duhet të diskutohet në këtë takim ka të bëjë me diçka tjetër. Ai tha se duhet të jemi të sigurtë para qytetarëve të Kosovës, kur dihet se asnjëherë si institucione nuk është vepruar në veri të Kosovës, sepse ka vepruar sistemi paralel i sistemit të Serbisë, ndërsa tani situata është ndryshe, pra pas marrëveshjes së Brukselit.

Abelard Tahiri, tha se marrëveshja për drejtësi është nënshkruar në vitin 2015 dhe ka filluar implementimin dy vite më vonë, pra në vitin 2017, ishte Republika e Kosovës e vetme si shtet, me mbështetje të Komisionit Evropian dhe të USID-it, që ka bërë implementimin e kësaj marrëveshjeje, ndërsa roli i palës serbe, në këtë rast, ka qenë vetëm tërheqja nga financimi i strukturave paralele në atë kohë. Rol tjetër nuk ka pasur, përveç që të pajtohet me një realitet të ri që po krijohet në Kosovë dhe që gjykatat po vendosen the themelohen në kuadër të sistemit tonë gjyqësor dhe prokurorial. Më tej, theksoi se e kupton shqetësimin e deputetes Haxhiu, që disa gjyqtarë paguhen dhe nuk shkojnë në punë, por nuk mund ta kuptoj shqetësimin politik që po shpreh karshi gjyqësorit dhe prokurorisë, sepse kjo pastaj po kuptohet si tendencë që edhe gjyqësori edhe prokuroritë të jenë pjesë e debateve politike. Ministri Tahiri shtoi se padyshim që është histori suksesi, vendosja e sistemit tonë pas 18 viteve në veri të Mitrovicës, kur dihet se në katër komuna nuk ka pasur fare gjyqtarë, nuk ka pasur prokurorë, ndërsa sot i kemi, theksoi z. Tahiri. Ndërsa, sa i përket planit B, ai tha se do të veprohet sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës. Pra, në momentin që një gjyqtar largohet, duhet të fillohet procedura për zëvendësimin e tij.

Nehat Idrizi, tha se për letrën e Nikolla Kabashiq janë informuar përmes rrugëve jozyrtare. Sa i përket masave që duhet ndërmarrë, ai tha se nuk guxojnë të marrin masa pa i përfillur procedurat. Si hap të parë, ai përmendi shkresën e drejtuar të gjithë gjyqtarëve dhe stafit ku iu është kërkuar të përmbahen nga çdo deklaram publik që nuk i përket gjyqësorit, ndërsa hapi tjetër është ftesa për kryetarin që të deklarohej rreth shkresës që ka dërguar, pastaj janë procedurat tjera që do t'i ndjekim, tha mes tjerash z. Idrizi. Ndërsa, sa i përket pagesës së dy gjyqtarëve, të cilët nuk kanë shkuar në punë. Kjo ka ndodhur në kohën para se të integrohen gjyqtarët në veri të Mitrovicës, pas njoftimit që kemi marrë për të njëjtit është shqiptuar masa disiplinore dhe tani nuk ka më asnjë rast të tillë. Duke iu përgjigjur deputetit Sherifi, ai tha se është e vërtetë që kur kemi të bëjmë me grupe, është problem, pavarësisht asaj që tani kemi të bëjmë me raste individuale, në këtë rast, ai përmendi edhe grevën e administratës së gjyqësorit, me ç' rast tha se nuk është ndërmarrë asnjë masë.

Në këtë diskutim, ndërhyri deputetja Haxhiu, duke thënë se sipas ligjit, këta punëtorë të administratës së gjyqësorit kanë të drejtë të mbajnë greva, në mënyrë që të kërkojnë të drejtat e tyre, sepse nuk është e drejtë, në asnjë mënyrë, të bëhet ky krahasim, theksoi znj. Haxhiu. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, në pyetjen e deputetit Beqa se a ka pasur informata zyrtare që do të ndërpritet puna atje, tha se është njoftuar vetëm me telefon nga kryetari që periudha e ndërprerjes së punës, në kohën kur mbahen protestat, është për shkak të rrethanave që mund të krijohen. Ndërsa, duke iu përgjigjur pyetjes së z. Kurteshi se nëse zgjatet kjo situatë a ka ndonjë plan B, ai tha se nuk është paramenduar se do të ketë një situatë të tillë, por varësisht nga rrethanat edhe do të veprohet.

Bahri Hyseni, tha se dihet se një kohë të gjatë nuk është punuar në atë pjesë dhe si rezultat i kësaj ka grumbullim të mijëra lëndëve, ndërsa tani për shkak të funksionalizimit janë dorëzuar të gjitha lëndët, në këtë drejtim, Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka marrë me shqetësim numrin e madh të lëndëve, dhe me qëllim që të mos parashkruhen këto lëndë, është formuar një komision dhe së shpejti do të vizitohet Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ku do të mblidhen të gjitha lëndët dhe do të studiohen afatet, sidomos ato të cilat janë para skadimit, ku do të raportohet në Këshill. Po ashtu, këtë rast do të marrim vendim që t'i shkohet në përkrahje Mitrovicës dhe mos të lejohet që asnjë rast ku është kryer veprë penale të parashkruhet, thekoi prokurori Hyseni.

Kryetarja kërkoi nga anëtarët e komisionit që të deklarohen rreth rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se u miratua rendi i ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256

Kryetarja, tha se ka qenë vendim i komisionit që të bëhet kjo nismë legislative, që ka të bëjë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03.L-256, pikërisht për votimin jashtë vendit ,e cila ka qenë kërkesë e Avokatit të Popullit, në raportin që i ka rekomanduar komisionit për plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Korab Sejdiu, tha se me këtë nismë, grupi punues iu është përmbajtur në mënyrë strikte rekomandimeve të dala nga Avokati i Popullit dhe përkundër tentativave që ka nevojë për reformë të gjerë zgjedhore, kemi ardhur në përfundim që për një gjë të tillë duhet të ketë vullnet më të madh politik e që aktualisht nuk ekziston, prandaj fokusi ka qenë vetëm në çështjen e votimit jashtë vendit. Më tej, z. Sejdiu duke falënderuar të gjithë aktorët që kanë dhënë kontribut gjatë grupit punues, kërkoi që të përkrahet kjo nismë.

Kryetarja theksoi se në nenin 1, përkufizimi i ambasadave ka dy propozime: A dhe B. Anëtarët e komisionit u pajtuan që të përkrahet propozimi B.

Sami Kurteshi, lidhur me propozimin e tij për votimin fizik dhe me postë, tha se duhet të shtohet që posta të vijë 24 orë para hapjes së vendvotimeve fizike jashtë dhe të numërohen të në njëjtën kohë në ambasada dhe konsullata, ndërsa çështja tjetër, pra për votimin fizik dhe me postë i shtetasve të Kosovës që jetojnë në vendet ku nuk ka ambasada dhe konsullata, z. Kurteshi mori shembull Finlandën ku nuk ka asnjë përfaqësi, por Ambasada e Kosovës në Suedi e përfaqëson Kosovën në Finlandë dhe Norvegji. Pra votuesve duhet t'u mundësohet që votojnë në ambasadën dhe konsullatën në Suedi, theksoi deputeti Sami Kurteshi.

Bilall Sherifi, tha se do të ishte problem nëse votuesit do të kufizohen që të votojnë vetëm nëpër ambasada, sepse është hapësirë e pamjaftueshme, është e pamundur që të zbatohet një praktikë.

Kryetarja sqaroi se është diskutuar në grup punues kjo çështje, pra janë diskutuar mundësitë që votimi të bëhet me postë, në ambasada dhe në konsullata, por megjithatë propozimet tjera do të adresohen në momentin kur komisioni do ta shqyrtojë, theksoi ajo.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256, ta dërgojë në kryesi për procedim të mëtejme.

3. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, komisioni nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar.

1. Formohet grupi punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për hetim parlamentar, me këtë përbërje:
 1. Albulena Haxhiu, kryesuese;
 2. Hajdar Beqa, anëtar;
 3. Bilall Sherifi, anëtar;
 4. Shkumbin Demaliaj, anëtar.

Mbledhja përfundoi në orën 14.50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetare e komisionit,

Albulena Haxhiu